

VENDIM
Nr. 107, datë 7.11. 2014

FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“AXPO ALBANIA” SHA NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE NR. 102, DATË 21.12.2009

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, germa “a”; 9 ; 45 pika “4” dhe 48 pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “P”; 5 pika 1 germa “P”; 13 ; 14 pika 1 dhe 16 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.11.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “AXPO ALBANIA” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “AXPO ALBANIA” sh.a. plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar ,tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 gjerat “a”, “b”, “c”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për rinovimin e licencës së shoqërisë “AXPO Albania” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 102, datë 21.12.2009.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti